



KUVENDI I
KOSOVËS
Shtator, 2007

KOMISIONI PËR SHËNDETËSI, PUNË DHE MIRËQENIE SOCIALE

PLANI I PUNËS 2007

Komisioni ynë është një nga komisionet e para të Kuvendit të Kosovës i cili ka përpiluar planin vjetor të punës. Plani vjetor i punës është përpiluar dhe ka filluar të aplikohet nga muaji janar. Në agjendën e Komisionit për këtë vit janë shqyrtimi dhe amendamenti i ligjeve që bien në fushë të këtij komisioni, monitorimi i ligjeve, vizita institucionale të ndryshme sociale dhe shëndetësore dhe mbajtja e dëgjimeve publike. Plani i punës ka rritur nevojën e bashkëpunimit në mes të zyrës mbështetëse të komisionit dhe zyrave ligjore të Qeverisë (zyrën ligjore të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, zyrën ligjore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe zyrën ligjore të Kryeministrit), ngase plani vjetor i punës i Komisionit është i bazuar në masë të madhe në strategjinë legjislativë të Qeverisë dhe nga e cila kërkon që ti përmbahet afateve për procedimin e projektligjeve në Kuvend ashtu siç parashihet me strategjinë e saj legjislativë.

TAKIMET E KOMISIONIT

Gjatë periudhës shtatë mujore të këtij viti Komisioni ka mbajtur 19 (nëntëmbëdhjetë) takime. Takimet e komisionit kryesisht janë zhvilluar me qëllim të shqyrtimit dhe amendamentimit të projektligjeve, dëgjimit të zyrtarëve qeveritarë që janë ftuar të raportojnë para Komisionit, shqyrtimin e raporteve nga institucionet shëndetësore dhe takime të ndryshme me ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë. Takimet e Komisionit kanë qenë të hapura për publikun dhe janë përcjellur nga përfaqësues të mediave dhe monitorues të organizatave të ndryshme.

FUSHËVEPRIMTARIA E KOMISIONIT

Komisioni Parlamentar për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale është komision funksional i Kuvendit të Kosovës.

Ky komision ka 14 anëtarë që vijnë nga parti të ndryshme të përfaqësuar në Kuvend. Komisioni angazhohet për përcaktimin dhe përcjelljen e zbatimit të politikave për zhvillimin dhe funksionimin efikas të shëndetësisë në Kosovë. Komisioni angazhohet për konceptimin e strategjisë së përgjithshme për mbrojtjen shëndetësore të qytetarëve të Kosovës dhe të tjerëve që përkohësisht gjenden në Kosovë, duke nxitur aplikimin e standardeve bashkëkohore të shëndetësisë dhe integrimin e institucioneve tona shëndetësore në asociacionet ndërkombëtare të shëndetësisë.



Komisioni mbulon aktivitetet e dy ministrive: Ministrinë e Shëndetësisë dhe Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Projektligjet të cilat arrijnë në Kuvendin e Kosovës e të cilat janë të fushës së shëndetësisë, mirëqenies sociale apo çështjeve të punës, shqyr-tohen dhe amendamentohen nga ana e

Komisionit të Shëndetësisë, Punës dhe Mirëqenies Sociale. Deri më tani Komisioni ka shqyrtuar dhe miratuar 21 ligje që janë nga dy fushat kryesore që mbulon ky Komision. 13 ligje janë në kompetencë të Ministrisë së Shëndetësisë dhe 8 në kompetencë të MPMS. Nga ligjet e miratuara 18 janë shpallur nga PSSP.

SHQYRTIMI I PROJEKTLIGJEVE

Gjatë periudhës shtatë mujore të këtij viti (2007) Komisioni ka marrë në shqyrtim shtatë projektligje: Projektligjin për Transfuzionin e Gjakut, Kontrollin e Gjakut dhe Produkteve të tij, Projektligjin për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, Projektligjin për Ushqimin, Projektligjin për Punën,

Projektligjin për Liritë dhe të Drejtat e Organizimit Sindikal, Projektligjin për Grevat dhe Projektligjin për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit mbi Inspektoratin e Punës. Nga këto shtatë projektligje, dy prej tyre tani më kanë kaluar leximin e dytë në Kuvend pasi janë votuar së bashku me amendamentet që i ka bërë ky komision (Projektligji

për Transfuzionin e Gjakut, Kontrollin e Gjakut dhe Produkteve të tij dhe Projektligji për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse). Tre nga këto projektligje janë në procedurë të amendamentimit (Projektligji i Punës, Projektligji mbi ushqimin dhe Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit mbi Inspektoratin e Punës).

KONTAKT INFORMATAT:

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, zyra E -213

Tel: 038 211 326 dhe 038 211 507

E-mail: drita.çerkaxhiu@assembly-kosova.org & rrahim.demaj@assembly-kosova.org

Gjatë shqyrtimit të projektligjeve nga ana e komisioneve parlamentare, komisionet kanë të drejtë që të mbajnë dëgjime publike. Dëgjimet publike mbahen në rastet kur anëtarët e Komisionit vlerësojnë se dëgjimi publik do t'u ndihmonte në amendamentimin e projektligjit që është në shqyrtim. Pra, me qëllim të përmirësimit të kualitetit të projektligjit i cili është sjellë për shqyrtim në Komision, organizohen dëgjimet publike me ç'rast ftohen ekspertë të cilët mund të japin ekspertizën e tyre në amendamentimin e një projektligji të caktuar, si dhe asociacione, organizata joqeveritare dhe qytetarë të cilët preken drejtpërdrejtë nga ligji që do të miratohet.

Gjatë periudhës janar-korrik 2007, Komisioni Parlamentar për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale ka mbajtur dy dëgjime publike. Këto dy dëgjime publike kanë mbuluar katër projektligje me të cilat

DËGJIMET PUBLIKE



merrej Komisioni në fjalë: një projektligje mbulonin fusha dëgjim publik është mbajtur për pothuajse të ngjashme dhe të Projektligjin për Transfuzionin e ftuarit mund të jepnin kontributin e Gjaktut (09.01.2007) dhe dëgjimi tyre për të tri projektligjet. Në këtë tjetër publik është mbajtur për tri dëgjim publik kanë qenë të ftuar projektligje: Projektligjin e Punës, 27 pjesëmarrës (përfaqësues të Projektligjin për Liritë dhe të institucioneve, shoqatave, Drejtat e Organizimit Sindikal dhe organizatave joqeveritare dhe Projektligjin për Grevat ekspertë të pavarur). Pjesa Gjaktut (16.02.2007). Është vendosur që dërmuese e të ftuarve ju ka një dëgjim publik të mbahet për tri përgjigjur ftesës dhe kanë projektligje për shkak se këto tri kontribuar në këtë dëgjim publik

duke propozuar amendamente të cilat pasi i kanë argumentuar para deputetëve i kanë dorëzuar edhe më shkrim në Komision. Ndër amendamentet më të rëndësishme kanë qenë ato të: sindikatës së KEK-ut, sindikatës së PTK-së, BSPK-së, AKB (Aleanca Kosovare e Bizneseve), pensionistëve, Zyra për Barazi Gjinore, etj.

Dëgjimi publik është cilësuar si shumë i frytshëm dhe amendamentet e propozuara nga ana e pjesëmarrësve janë shqyrtuar me kujdes dhe disa prej tyre janë inkorporuar në amendamentet e propozuara në raportin e komisionit. Në përpjekje për të lehtësuar organizimin e dëgjimeve publike, së fundi personeli i Komisionit ka përgatitur një bazë të të dhënave me kontakt informatat e organizatave dhe ekspertëve relevantë të cilët mund të ftohen të japin kontributin e tyre gjatë dëgjimeve publike.

VIZITAT NË TERREN

Gjatë vitit 2007 Komisioni ka realizuar dy vizita në institucionet sociale dhe shëndetësore. Më 13 mars Komisioni ka vizituar njërin nga Qendrat e Mjekësisë Familjare në Prishtinë (QMF) për tu njoftuar nga afër me punën dhe sfidat me të cilat përballlet ky institucion. Gjithashtu më 3 prill Komisioni ka vizituar "HandiKos"-in për tu njoftuar me brengat e personave me aftësi të kufizuara dhe i ka njoftuar ata për hapat e ardhshëm që do të ndërmerren Komisioni për procedimin e ligjeve të reja për mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në Kosovë. Komisioni planifikon që deri në fund të vitit të organizojë vizita edhe në institucione të tjera shëndetësore dhe sociale në Komuna të ndryshme të Kosovës.

AKTIVITETET E KOMISIONIT NË TË ARDHMEN

Komision edhe në muajt në vazhdim do të angazhohet në shqyrtimin dhe amendamentimin e ligjeve. Komisioni shpreson se deri në fund të këtij viti do të kryej punën edhe me ligjet që janë shqyrtim, si: projektligjin e punës, projektligjin për grevat, projektligjin për liritë dhe të drejtat e organizimit sindikal, projektligjin për barnat narkotike, substancat psikotrope dhe prekursorët, projektligjin për rehabilitimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara, projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për skemën e ndihmës sociale. Komisioni do të bashkëpunojë me organizatat vendore dhe ndërkombëtare, do të rris vizibilitetin karshi qytetarëve dhe do të vazhdojë punën në mbikëqyrjen e ekzekutivit.

MONITORIMI I IMPLEMENTIMIT TË LIGJEVE

Gjatë vitit 2006 Komisioni ka monitoruar Ligjin për Shëndetësi dhe nga ky monitorim ka nxjerrur shumë rekomandime të cilat janë prezantuar para Kuvendit të Kosovës dhe pas aprovimit i janë dërguar Ministrisë së Shëndetësisë me qëllim të implementimit më të mirë të Ligjit të Shëndetësisë. Meqë një nga funksionet e komisioneve parlamentare është monitorimi i punës së ministrive përkatëse, këtë vit

komisioni është fokusuar në mbikëqyrjen e punës së këtyre ministrive rreth asaj se a po i nxjerrin aktet nënligjore me kohë dhe në përputhje me ligjet e miratuara nga Kuvendi. Me ndihmën e NDI, Komisioni ka bërë një hulumtim lidhur me përputhshmërinë e akteve nënligjore të cilat bazën e kanë në këto tri ligje: *Ligjin për Skemën e Ndihmës Sociale*, *Ligjin për Metodologjinë e caktimit të lartësisë së pensionit bazë në Kosovë dhe*

caktimin e datës për sigurimin e pensionit bazë dhe Ligjin mbi Sigurinë në Punë, Mbrojtje të Shëndetit të Punësuarve dhe Ambientit të Punës.

Në bazë të të gjeturave nga këto monitorime, Komisioni do të dërgoj disa rekomandime në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale me qëllim të përmirësimit të kualitetit të akteve nënligjore, nxjerrjen e tyre me kohë dhe në përputhje me ligjin në të cilin bazohen këto akte juridike.